



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 20.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.03.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparar, Sistem zërimi, ndricim profesional", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1635-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-014-121, **nxjerr:**

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "INFINITT" SH.P.K e dt.15.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparar, Sistem zërimi, ndricim profesional", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1635-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-014-121, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 29.02.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.**
- 2. Korigjohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 29.02.2024;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë .**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .**



Arsyetim

Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K me dt.15.03.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparate, Sistem zërimi, ndricim profesional", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1635-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-014-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë, merret si i bazuar dhe në këtë pikë autoriteti kontraktues do të bëjë korigjimin e dosjes së tenderit;);

Pretendimi juaj i dytë nuk qëndron sepse ky është një projekt i planifikuar dhe konstatohet se të gjitha aktivitetet janë të së njëjtës fushë;

Pretendimi juaj i tretë nuk qëndron, sepse projekti ka të bëjë me furnizim dhe instalim të pajisjeve teknologjike, për këtë arsye kërkojmë që staf i profesional të jetë ashtu siç është kërkuar në FDT-ë;

Pretendimi juaj i katërt, mirret si i bazuar dhe në këtë pikë Autoriteti kontraktues do të bëjë korigjimin e dosjes së tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

